

# PARA SE TË MERRNI QEN

**Mbajtja e qenve si pjesë e familjes** mund të jetë jashtëzakonisht shpërblyese. Megjithatë është e rëndësishme të mbani mend se kujdesi për një kafshë është gjithashtu një përgjegjësi e madhe.

Para se të vendosni të mbani qen, është absolutisht thelbësore të hulumtoni kujdesin që do t'i duhet qenit për t'u siguruar që keni kapacitetet e nevojshme për t'i përmbushur **nevojat fizike, fiziologjike dhe psiçike të kafshës.**







## A DUHET TË MERRNI QEN NË SHTËPI?

**Orari i punës, jeta e ngarkuar sociale dhe udhëtimet e rregullta janë faktorë që duhet të mirren parasysh me kujdes para se të sjellni një qen në familjen tuaj.**

Qentë kanë nevojë për shoqërinë e njerëzve dhe kafshëve tjera dhe gjithmonë do të varen nga ju. Duhet të siguroheni që stili i jetës tuaj t'ia përshtatni qenit. Para se të adoptoni ose blini një qen, merrni parasysh kërkesat e tyre specifike.

*A jeni gati të shëtisni qenin tuaj çdo ditë?*

*A keni kohë për të trajnuar qenin tuaj për ushtrimet bazike që i nevojiten?*

*Kush do të kujdeset për qenin kur nuk jeni në shtëpi ose kur udhëtoni?*

*Nëse jetoni me njerëz të tjerë, a pranojnë të gjithë të merrni një qen?*

*A ka dikush në shtëpi alergji ndaj qenve?*



## JETËGJATËSIA E QENVE

**Jetëgjatësia mesatare e qenve është rreth 12 vjet, me disa qen që jetojnë deri në moshën 15 vjet apo më shumë, kështu që mbajtja e qenit është një angazhim afatgjatë.** Edhe pse këlyshët janë jashtëzakonisht simpatik, ata rriten shpejt dhe duhet të përgatiteni të kujdeseni edhe për një kafshë të rritur me kërkesa të konsiderueshme për stërvitje, socializim dhe dietë.



## KOHA

**Bëhuni gati të sakrifikoni kohën tuaj.** Ngjashëm me një fëmijë të posalindur, sjellja e një qeni të ri në shtëpinë tuaj do të thotë që ju të merrni përgjegjësinë për t'u kujdesur për një qenie të gjallë, nevojat e së cilës shpesh kanë prioritet para nevojave tuaja. Kjo do të thotë që duhet të sakrifikoni më shumë kohë dhe energji për një qen në shtëpinë tuaj, sesa keni menduar fillimisht ose që jeni mësuar.



**A jeni të gatshëm të shëtisni qenin tuaj çdo ditë, disa herë në ditë dhe në çdo mot?**

Nuk mund të udhëtoni për një fundjavë me miqtë në minutën e fundit siç mund të jeni mësuar. Duhet të planifikoni se kush do të ushqejë, shëtisë dhe kujdeset për qenin në mungesën tuaj.





## KOSTOT FINANCIARE

Mbajtja e qenit ka kosto të konsiderueshme financiare. Ju duhet të merrni parasysh koston e çdo gjëje që i nevojitet qenit, duke filluar nga ushqimi dhe kujdesi veterinar, te lodrat dhe trajnimet, gjatë gjithë jetës së tyre.

### Disa nga kostot që duhet të planifikoni:

- ✘ Kostot veterinare (përfshirë kostot e trajtimeve emergjente)
- ✘ Vaksinimet vjetore
- ✘ Trajtimi i rregullt kundër parazitëve të brendshëm dhe të jashtëm
- ✘ Kastrimi/Sterilizimi
- ✘ Ushqimi për qen me vlera të larta ushqyese dhe enët për ushqim dhe ujë
- ✘ Qaforet dhe litarët
- ✘ Identifikimi me mikroçip dhe regjistrimi (mund të gjobiteni nëse qeni juaj nuk është i regjistruar)
- ✘ Shtrati i qenit
- ✘ Kurse të trajnimit dhe socializimit
- ✘ Litar ose kafaz për veturë
- ✘ Lodra për qen
- ✘ Akomodomi i qenit në rast se udhëtoni
- ✘ Shëtitja e qenit nëse nuk jeni në shtëpi për orë të tëra gjatë ditës



## HAPËSIRA

Konsideroni me kujdes nëse mund të siguron strehim dhe hapësirë të përshtatshme për qenin ku ka mbrojtje nga faktorët e jashtëm si moti i ftohtë apo i nxehët dhe rehati të nevojshme, tani dhe në të ardhmen.

1?

A keni oborr? A është i rrethuar? Nëse nuk keni oborr, ku do të rrijë qeni kur nuk jeni në shtëpi? Nëse qeni do të rrijë brenda (vlen sidomos për qentë e mbajtur në apartamente), a keni kohë të shkoni në shtëpi për ta nxjerrë qenin jashtë çdo disa orë për t'i kryer nevojat fiziologjike dhe për ta shëtitur?







## USHTRIMET DHE SOCIALIZIMI

Para se të merrni qen, duhet të siguroheni që qeni i juaj të mësohet me rregullat bazë të sjelljes me njerëz dhe qen të tjerë në hapësira publike apo edhe brenda shtëpisë.

Qentë kanë shumë energji dhe kanë nevojë për ushtrime dhe shëtitje të përditshme. Kjo do të thotë që duhet të shëtisni qenin tuaj të paktën një herë në ditë për të paktën 2 orë. Disa qen kërkojnë më shumë ushtrime se të tjerët, gjë që është shumë e rëndësishme të mirret parasysh kur zgjedhni një qen.

Qentë kanë nevojë për socializim me qen të tjerë dhe me njerëz. Duhet të keni parasysh që socializimi i qenit është thelbësor dhe kërkon vëmendje dhe kohë të dedikuar nga ana juaj.



## PËRKUJDESJA MJEKËSORE

Nuk ka asgjë më të rëndësishme se shëndeti dhe lumturia e qenit tuaj, prandaj sigurohuni që të keni një veterinar/e të mirë për trajtimin e qenit. Duhet të përgatiteni që mund të ketë nevojë për intervenime mjekësore urgjente në jetën e qenit tuaj. Qeni juaj mund të sëmuret dhe të lëndohet njësoj si çdo njeri, kështu që duhet të përcillni historikun e vaksinimeve për t'u siguruar që qeni është në gjendjen më të mirë shëndetësore.



## CILI LLOJ I QENIT JU PËRSHTATET?

Pavarësisht nëse doni të adoptoni ose bleni një qen, duhet të synoni të gjeni llojin e qenit që është më i përshtatshëm me stilin e jetës tuaj.

**Nëse doni të merrni një qen, disa faktorë duhet të mirren parasysh:**

- ✓ Madhësia e qenit
- ✓ Koha në dispozicion për përkujdesje
- ✓ Niveli i aktivitetit të qenit
- ✓ Raca/lloji
- ✓ Mosha
- ✓ Historiku mjekësor

Nëse vendosni të merrni qen, rekomandohet që qenin ta **adoptoni** nga ndonjë strehimore, rrugë apo nga ndonjë familjar apo mik që nuk ka mundësi ta mbajë qenin e vet (nëse lloji dhe raca e qenit ju përshtatet) për të ndihmuar në reduktimin e qenve pa pronar apo endacak.



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fondacija za prava životinja